



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 02**

**Datë: 18. 01. 2024. Ora: 10:00**

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, krye shëf i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyesë: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

**RENDI I DITËS**

1. Hyrje: Kreshnik Radoniqi, kryesues i mbledhjes së KQZ,
  2. Aktivitetet e Zyrës,
    - Rekomandimi për pezullimin e partisë politike “Partia Rome e Bashkuar e Kosovës” (PREBK)
  3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për autorizimin e Sekretariatit për të lidhur marrëveshje me palën e tretë,
  4. Njoftim nga tkaimi për mundësitë e anëtarësimit në rrjetin e institucioneve elektorale nacionale frankofone,
  5. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregulloreve të Brendëshme,
  6. Të ndryshme.
- 

1. **Hyrje: Kreshnik Radoniqi, kryesues i mbledhjes së KQZ:**

**Kreshnik Radoniqi**, kryesues i mbledhjes i njoftoi të pranishmit lidhur me agjendën e takimit, dhe se në këtë takim mungon me arsyë anëtari Arianit Elshani.

Anëtarët e KQZ-së me 10 pika për miratuan rendin e ditës.

## **2. Aktivitetet e ZRCKFSP:**

Rekomandimi për pezullimin e partisë politike “Partia Rome e Bashkuar e Kosovës” (PREBK):

Në këtë pikë referoi drejtori Besnik Buzhala i cili e informoi KQZ-në se, zyra e ka dërguar këtë rekomandim për pezullimin e subjektit sepse PREBK ka qenë e obliguar që ta mbajë kuvendin e partisë deri më datën 6 janarë të këtij viti. Zyra, nuk ka asnjë komunikim nga ky subjekt, njoftim a kërkesë për shtyrjen e kuvendit. Sipas rregulles nr.1/2023 zyra rekomandon që ky subject të pezullohet dhe në afat shtesë prej 45 ta mbaj kuvendin.

Rekomandimi ynë, është që ky subject tani të pezullohet.

**Sami Kurteshi:** Ky, është rasti I tretë a katër që sipas rregullores dhe ligjit po I pezullojmë. Jemi duke bërë diskriminim, sepse e kemi pasur një rast dhe nuk e kemi pezullu. Në rrethana të njejta dhe kushte të njejta, një subject nuk e kemi pezullue. Ky, është rast diskrimiunes dhe unë, do ta theksoj vazhdimisht...

Me 10 vota për aprovohet rekomandimi i ZRCKFSP –së për pezullimin e Partisë rome të bashkuar të Kosovës, dhe obligohet ky subject që në afat prej 45 ditëve ta mbajë kuvendin.

## **3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për autorizimin e Sekretariatit për të lidhur marrëveshje me palën e tretë:**

**Burim Ahmetaj** tha se Sekretariati lidhur me informimin që e ka bërë për pozitën vakante të Zyrtarit të Prokurimit, sipas rendit ka dërguar kërkesa në disa institucione për të për të përkrahur KQZ-në me zyrtarë të prokurimit. Vetëm komisioni për miniera dhe minerale, ka kthyer përgjigje positive. Ne, kemi zhvilluar procedurat e nevojshme, dhe tani ne kërkojmë vendimin që duhet ta bëjë KQZ. Draft – marrëveshja dypalëshe, kërkon miratimin tuaj.

Sami Kurteshi: Unë pajtohem, por ju që po nënshkruheni si “Kryeshef”, ndërsa që ligji I ri në fuqi, juve ju autorizon të nënshkruheni si “Drejtor”. Ju, po e shkëlpi ligjin...

Me 10 vota për u miratua kërkesa për autorizim të Sekretariatit për formalizimin e marrëveshjes me KPMM-në.

4. Njoftim nga takimi për mundësitë e anëtarësimit në rrjetin e institucioneve elektorale nacionale frankofone:

**Kreshnik Radoniqi**, e njoftoi KQZ-në për takimin me z. Avni Hasanin dhe Shemi Krasniqin. I pari është koordinator nacional për organizatën e Frankofonisë nga Ministria e Punëve të Jashtme, dhe i dyti, është përfaqësues i PResidencës në këtë organizatë. Në diskutim, jemi inkurajuar që të jemi pjesë e kësaj organizate. Dhe, unë e hapi diskutimin lidhur me këtë, megjithëse unë preferoj që është mirë të jemi anëtarë. Për të qenë pjesë e organizatës, paguhet një tarifë. Nëse kalon, e vendosim në buxhet pastaj...

Në këtë pikë, diskutuan: Ilir Gashi, i cili kërkoi më shumë informacione, ndërsa z. Kurteshi tha se Kuvendi ynë është anëtarë i Frankofonisë...Kjo është një organizatë me më shumë se 40 anëtarë, dhe kryesisht janë vende ish koloniale – afrikane. Nuk ka kushedi cfarë beneficione, por është mirë të jemi...

5. Shyrtimi dhe miratimi i Rregulloreve të Brendëshme:

**Sami Hamiti**, tha se Rregullorja për zgjedhjen e drejtorit të SKQZ-së, ta trajtojmë në një mbledhje tjetër. Me mirëkuptim...

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së diskutuan çështjet e mëtejshme të shqyrtimit të rregulloreve të brendëshme të KQZ-së.

6. Të ndryshme.
-

